VENDIM
Nr. 559, datë 27.7.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 44, DATË 27.1.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KUSHOVË, TË QARKUT TË ELBASANIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 44, datë 27.1.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në titullin e vendimit, fjalët "… të komunës Kushovë …" zëvendësohen me "… të njësisë administrative Kushovë, Bashkia Gramsh …".

b) Në listën e inventarit, pronës me numër rendor 95 t'i ndryshojë emërtimi dhe sipërfaqja, sipas formularit bashkëlidhur, gjithsej, 1 (një) fletë.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Gramsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Gramsh / Njesia / Administrative Kushove :

Fusha e perdorimit te Prones : Zhvillim ekonomik

Identifikoi: Dhurata Çimo (Specialiste e Aseteve) nr,cel .069 64 85 329 ose 0675298198
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Manjola Çekrezi (Angjensia e Inspektimit te Territorit)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Luljeta Dollani (Kryetari i Bashkise)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

	A				B		C			
Nr. Rend	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
95	1272 151-C	120/14	truall ndertese	ish shkolle Fshati Bregas Njesia Admnistrative Kushove Bashkia Gramsh	300	87	Zhvillim ekonomik	Njesia administrative Kushove Bashkia Gramsh	Njesia administrative Kushove Bashkia Gramsh	Objekti eshte jasht funksionit mbas verefikimi ne terren te prones prona me nr pasurie 120/14 të hiqet si emertim gabine elektrike dhe dhe të vendoset ish shkolle .Per te vazhduar proçeduren për korigjim te lista perfundimtare te inventarit per Njesin Administrative Kushove . Korgjimi tëbehet Sipas listes se invenarit nr .rendor ,95 faqe 17.